



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rr. "Driton Hoxha" nr. 55, Lakrishte, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 (0)38 500 400, Fax: + 383 (0)38 248 076, e-mail: info@pak-ks.org, ueb: www.pak-ks.org

Bazuar në Nenin 47, paragrafin 10 të Ligjit Nr. 08/L – 197 për Zyrtarët Publik të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, Rregulloren (QRK) NR 05/2024 për ndryshim dhe plotësim të Rregullores 15/2023 dhe Vendimin me numër A.nr. 879/2025 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës (në tekstin e më poshtëm KPMSHCK) të datës 14.07.2025, pranuar në AKP me datë 23.07.2025 me Nr. Protokolli 3588, Divizioni i Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me datë 24 Korrik 2025, publikon këtë:

NJOFTIM PËR ANULIM

Agjencia Kosovare e Privatizimit me datë 07 Shkurt 2025, ka shpallur konkursin me nr. reference RN00016650 për pozitën ZYRTAR I LARTË I SHITJES DIREKTE në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Pas përfundimit të procedurës së rekrutimit dhe shpalljes së rezultateve përfundimtare, kandidati, i pakënaqur me procesin e rekrutimit nr. ref.: RN00016650, ka parashtruar ankesë në KPMSHCK.

KPMSHCK, me Vendimin A.nr. 879/2025, ka aprovuar si të bazuar ankesën e parashtruar nga ankuesi dhe obligon AKP-në të "Anuloj në tërësi procedurën e rekrutimit të shpallur sipas konkursit me nr. ref. RN00016650", për dy (2) pozitat e punës "Zyrtar i Lartë i Shitjes Direkte", në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë.

Andaj, Divizioni i Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, njofton për anulimin e procedurës së rekrutimit me nr. ref. RN00016650.

Këshillë juridike: Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditësh.

Prishtinë, 24 Korrik 2025

Fatos Meqa

Udhëheqës i Burimeve Njerëzore

Agjencia Kosovare e Privatizimit